



Maahanmuuttovirasto
Migrationsverket
Finnish Immigration Service



TURVAPAikka-,
MAAHANMUUTTO- JA
KOTOUTTAMISRAHASTO

Euroopan unionin tuella

Informata azilkërkuesit



Fëmijët pa mbikqyrës




KE IKUR NGA VENDLINDJA DHE NGA FINLANDA KE KËRKUAR STREHIM.

Ke thënë se je nën moshën 18-vjeçare. Sipas ligjit të Finlandës të gjithë nën moshën 18-vjeçare janë fëmijë. Ata kanë të drejtë në strehim dhe kujdes të veçantë. Të gjithë fëmijët që gjinden në Finlandë kanë të drejtat e njejta, p.sh. të drejtën të vijnë shkollën dhe të marrin kurim për sëmundjet.

Ke ardhur në Finlandë pa mbikqyrësit tënd. Sidoqoftë, ti nuk je vetëm dhe do të kesh ndihmën e shumë të rriturve. Punonjësit e qendrës pranuese kujdesen për mirëqenjen dhe edukimin tënd. Poashtu, do të merr në ndihmë përfaqësuesin i cili të ndihmon në gjërat me zyrtarët.

Këtu tregohet se çka ndodhë kur kërkon azil në Finlandë. Për informacione tjera mund të pyet në qendrën tënde pranuese ose përfaqësuesin tënd.



ZYRTARËT KANË OBLIGIM TA RUAJNË FSHEHTËSINË

- Në Finlandë mund ti besosh zyrtarëve, si për shembull policëve, punonjësve të Rojeve kufitare dhe të Drejtorisë së imigracionit. Ata janë profesionistë dhe punojnë sipas ligjeve.
- Të gjithë zyrtarët që shqyrtojnë lëndën tënde kanë obligim ta ruajnë fshehtësinë. Kjo don të thotë se ata nuk guxojnë ti tregojnë personave të huaj për gjërat që dëgjojnë në vend të punës. Përveç zyrtarëve obligimin e ruajtjes së fshehtësisë e kanë edhe punonjësit e qendrës pranuese, përkthyesit dhe asistentët tuaj juridik apo avokatët.





Kështu përparon procesi yt i azilit

1. Tregoju punonjësve të Rojeve kufitare ose policisë se po kërkon azil.

Mund të kërkoh azil nga Finlanda vetëm këtu në Finlandë. Kur të arrijsh në Finlandë tregoju punonjësve të Rojeve kufitare ose policisë se kërkon azil. Organi zyrtar të regjistron si azilkërkuar, shkruan të dhënat tua themelore në regjistrin e të huajve, regjistron gjurmat e gishtërinjëve (vetëm mbi 6 vjeçarëve) dhe firmën tënde si dhe të merr një foto. Nëse ke pasaportën apo dokument tjetër identifikimi, tregoje atë organeve zyrtare.

Vëni re se dhënja e të dhënave personale të rrejshme/falso organeve zyrtare është vepër penale në Finlandë. Mbi 15-vjeçarët përgjigjen para ligjit në Finlandë.

- Gjatë kohës së shqyrtimit të aplikacionit tënd ke të drejtë të qëndron në Finlandë.
- Anëtarët e familjes tënde mund të aplikojnë për leje qëndrimi në Finlandë vetëm nëse ti vet ke marrë lejen e qëndrimit.



2. Organi zyrtar të drejton deri te qendra pranuese.

Gjatë kohës së shqyrtimit të aplikacionit tënd mund të banosh në qendrën pranuese. Aty banojnë edhe fëmijët tjerë prindërit/mbikqyrësit e të cilëve nuk janë në Finlandë. Në qendrën pranuese je i sigurt. Aty ka punonjës në çdo kohë, me të cilët mund të bisedosh dhe nga të cilët mund të kërkoh ndihmë.

Punonjësit e qendrës pranuese kujdesen çdo ditë për mirëqenien tënde, mirëmbajtjen dhe edukimin. Do të vijon shkollën dhe të njohtohesh me hobi të ndryshëm.

Ti duhesh ti respekton rregullat e qendrës pranuese dhe ti bën gjërat sipas marrëveshjes. Nëse ke probleme me fëmijët tjerë, tregoju punonjësve këtë gjë. Tregoju gjithmonë punonjësve të qendrës pranuese edhe ku gjindesh dhe përgjigju në telefon nëse të telefonojnë ata.

Qendra pranuese nuk mund të ndikon në shqyrtimin e aplikacionit tënd për azil.





3. Gjykata e qarkut të cakton përfaqësuesin.

Ata nën moshën 18 vjeçare sipas ligjit janë fëmijë dhe nuk mund ti kryejnë vet gjërat me zyrtarët në Finlandë. Për këtë arsye Gjykata e qarkut të cakton përfaqësuesin. Ai është person i moshës madhore i cili të ndihmon në procesin e azilit dhe në gjërat tjera zyrtare. Detyra e tij është të siguron që interesat tua të mirren parasyshtë në raste të ndryshme.

ÇFARË BËN PËRFAQSUESI?


- Përfaqësuesi dëgjon mendimin tënd për gjërat dhe siguron që zyrtarët ta marrin atë parasyshtë.
- Përfaqësuesi të informon për të drejtat dhe obligimet tua në procesin e azilit.
- Përfaqësuesi është me ty kur takohesh me zyrtarët, p.sh. në Drejtorinë e imigracionit ose në polici. Ai poashtu është në kontakt me zyrtarët në emrin tënd.
- Përfaqësuesi i tregon zyrtarëve mendimin e tij se cilat janë interesat e tua në situata të ndryshme.
- Sipas nevojës përfaqësuesi ta gjenë asistentin juridik ose avokatin dhe mbanë kontaktin me te.
- Përfaqësuesi firmos letrat e rëndësishme së bashku me ty.

ÇFARË NUK BËN PËRFAQSUESI:

- Përfaqësuesi nuk kujdeset për mirëqenjen e përditëshme dhe për edukimin tënd. Kjo është detyra e qendrës pranuese. Përfaqësuesi poashtu nuk ndërhyr në rregullat e brëndshme dhe principet e qendrës pranuese.
- Përfaqësuesi nuk të huazon para dhe nuk të blenë gjësende.
- Përfaqësuesi nuk mund të merr të banosh te ai.

4. Drejtoria e imigracionit sqaron, se a do të shqyrtohet aplikacioni yt në Finlandë.

Edhe pse ke aplikuar për azil në Finlandë, mund të ndodhë që aplikacioni yt të shqyrtohet në ndonjë shtet tjetër.



Shtetet anëtare të Bashkësisë Europiane dhe Norvegjia, Islanda, Zvicra dhe Liechtenstein veprojnë në përputhje me marrëveshjen e Dabliniit. Sipas saj aplikacioni yt mund të shqyrtohet vetëm në njërin nga këto shtete.

Trejoju zyrtarëve nëse:

- ke anëtarë të familjes ose të afërm në ndonjë Dablin-shtet
- ke leje qëndrimi ose vizë në ndonjë tjetër Dablin-shtet
- ke qëndruar më heret në ndonjë Dablin-shtet tjetër
- ti kanë marrë shenjat e gishtave në ndonjë Dablin-shtet tjetër
- ke kërkuar kuar azil më herët në ndonjë Dablin-shtet tjetër.

Nëse ti ke anëtarë të familjes ose të farefisit në ndonjë shtet tjetër të marrëveshjes së Dubliniit, do të përpiqemi që ty të bashkojmë me ta, ose në Finlandë ose në ndonjë shtet tjetër. Pas kësaj, aplikacioni yt për azil shqyrtohet në atë shtet. Nëse nuk ke anëtarë të familjes ose të afërm në ndonjë Dablin-shtet tjetër, aplikacioni yt shqyrtohet në Finlandë.

Aplikacioni yt mund të lihet pa u shqyrtuar edhe nëse:

- ke marrë strehim në ndonjë shtet të sigurt
- ke arrijtur në Finlandë nga një shtet i sigurt, ku ke mundur të merr strehim.



5. Në intervistë sqarohet arsyeja, pse kërkon azil.

Intervista e azilit është takim shumë i rëndësishëm.

Përfaqësuesi të ndihmon të pregaditesh për intervistë. Do të merr ftesën e Drejtorisë së imigracionit për intervistë. Lexo me kujdes së bashku me përfaqësuesin ftesën dhe shtesat e bashkangjitura ftesës. Punonjësit e qendrës pranuese të dërgojnë në intervistë.

Përfaqësuesi yt merr pjesë me ty në intervistë. Poashtu edhe asistenti yt juridik mund të merr pjesë në intervistë nëse është e nevojshme.

Në intervistë sqarohet se kush je dhe si ke ardhur në Finlandë. Tregoi saktë të dhënat e anëtarëve të familjes tënde. Të dhënat e gabuara më vonë mund të vështërsojnë sjelljen e familjes tënde në Finlandë.

Do të pyesin se pse ke ikur nga vendlindja dhe pse nuk mund të kthehesh më atje. Merr me veti të gjitha dëshmitë/provat e mundura që mbështesin tregimin tënd.

Me guxim të plotë tregoi të gjitha ato që i din dhe që mund të ndikojnë në azilkërkimin tënd. Poashtu trego nëse nuk din ose nuk të kujtohet ndonjë gjë. Trego nëse nuk e kupton përkthyesin ose ndonjë pyetje.

Është me rëndësi që ti thuash të gjitha bazat e aplikacionit tënd menjëherë. Nëse më vonë paraqet baza të reja, atëherë ti duhesh të kesh ndonjë arsye për atë se pse nuk i ke treguar këto baza më heret. Arsyeja duhet të jetë e tillë që ti nuk ke mundur të ndikosh në te.

Nga kjo bisedë do të shkruhet një procesverbal dhe një kopje e tij do të të jepet ty (nëse je mbi 15-vjeç) dhe përfaqësuesit tënd.



KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT

- Shqyrtimi i aplikacionit tënd për azil zgjatë maksimalisht 6 muaj. Prite vendimin i qetë.
- Nëse aplikacioni yt nuk mund të shqyrtohet në këtë afat kohor, nga Drejtoria e imigracionit do merr një lajmërim për këtë dhe vlerësimin se kurë do bëhet vendimi në aplikacionin tënd.
- Poashtu, ti mund të shiqon kohën që duhet pritur shqyrtimin edhe në faqet Drejtorisë së imigracionit në internet.

SQARIMET SHITESË

- Pas intervistës mund të dërgon sqarime shtesë Drejtorisë së imigracionit. Për shembull, mund të dërgon sqarim shtesë nëse në gjendjen tënde ka ndodhur ndryshim i konsiderueshëm për shkak të ngjarjeve të reja në vendlindje apo nëse në intervistë ke harruar të tregon për ndonjë gjë të rëndësishme.
- Bisedo për këtë gjë me përfaqësuesin tënd. Sipas nevojës, ai i dërgon informacionet shtesë Drejtorisë së imigracionit.

6. Do merr vendimin në aplikacionin tënd.

Pas intervistës Drejtoria e imigracionit vazhdon sqarimet rreth aplikacionit tënd. Sipas nevojës kërkon dhe sqarime shtesë nga përfaqësuesi yt. Kur të zgjidhet aplikacioni, do merr vendimin me shkrim.

Vendimi yt bazohet në Ligjin për të huaj, të dhënave që i ke dhënë në intervistë, në materialin tjetër që është prezentuar në këtë lëndë dhe në të dhënat që posedon Drejtoria e imigracionit për gjendjen në vendin tënd.

Vendimi yt mund të jetë pozitiv ose negativ. Policia ose Drejtoria e imigracionit ta lexon vendimin ty dhe përfaqësuesit tënd. Shqyrtoje vendimin së bashku me përfaqësuesin tënd.

VENDIMI POZITIV

Të ipet lejeqëndrimi, pra mund të qëndrosh në Finlandë. Të regjistrojnë automatikisht në sistemin e banorëve të Finlandës dhe të ipet numri personal.

Lejeqëndrimi mund të ipet në baza të ndryshme. Këto baza janë:

- 1) azili,
- 2) strehimi sekundar,
- 3) arsye individuale humanitare,
- 4) ndalimi i largimit nga vendi dhe
- 5) nëse je viktimë e trafikimit me njerëz.



Në vendim shifet baza e lejeqëndrimit tënd. Informacione tjera për bazat e leje qëndrimit gjenë në videot dhe faqet e Drejtorisë së imigracionit në internet.

Nëse nuk je i kënaqur me vendimin, mund të bësh apel me ankesë Gjykatës administrative. Asistenti juridik bën ankesën së bashku me ty dhe me përfaqësuesin tënd.

KARTA E LEJEQËNDRIMIT

Së bashku me vendimin merr edhe kartën e lejeqëndrimit. Kjo dëshmon se ke të drejtë të qëndrosh në Finlandë. Karta është valide aq sa dhe leja e qëndrimit.

KARTA E IDENTIFIKIMIT

Në Finlandë të nevojitet karta e identifikimit në mes tjerash për të hapur konto në bankë. Si dokument identifikimi vlenë pasaporta e shtetit tënd ose karta finlandeze e identifikimit. Në polici mund të aplikosh për kartë identifikimi.

DOKUMENTI I UDHËTIMIT

Sipas ligjit, ti duhesh të kesh dokument udhëtimi valid. Nëse të ipet azili, mund të aplikosh për dokument udhëtimi për refugjat. Nëse të ipet strehimi sekundar ose ndonjë lejeqëndrimi tjetër, mund të aplikosh për pasaportë për të huaj. Me këto dokumente mund të udhëtosh jashtë shtetit dhe të kthehesh në Finlandë.

SHPËRNGULJA NË KOMUNË

Kur merr lejen e qëndrimit, shpërngulesh nga qendra pranuese të banosh në shtëpinë familjare grupore. Aty mund të banosh deri sa ti mbushë 18 vite. Punonjësit e shtëpisë familjare grupore kujdesen për mirëqenien dhe edukimin tënd të përditshëm. Përfaqësuesi mbetet i njëjtë dhe të ndihmon në gjërat me zyrtarët deri sa ti mbushë 18 vite.



VENDIMI NEGATIV

Nuk të ipet leja e qëndrimit andaj nuk mund të qëndrosh në Finlandë.

Së bashku me vendimin negativ Drejtoria e imigracionit ta bën edhe vendimin për largimin tënd nga shteti.

Ty mund të ipet edhe ndalesë hyrje në shtet. Kjo don të thot se nuk mund të kthehesh mbrapa në Finlandë apo në territorin e Schengenit. Ndalesa mund të jetë në fuqi për kohë të pacaktuar apo me afat të caktuar.

PROCEDURA E SHPEJTUAR

Nëse sipas Drejtorisë së imigracionit aplikacioni yt është fare i pa bazë, në te bëhet vendimi negativ më shpejtë. Poashtu ty të largojnë më shpejtë nga shteti, zakonisht brënda 7 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

LARGIMI NGA SHTETI

Nëse vendimi yt përfundimtar është negativ, ti duhet të largohesh nga Finlanda. Nëse kthehesh vullnetarisht në vendlindje, mund të aplikon për asistencë për këthim. Nëse nuk kthehesh vullnetarisht, policia të këthen në vendlindje. Para se të kthejnë, policia verifikon se ty do të pranojnë në mënyrë të sigurt në vendlindjen tënde.

Nëse policia ka arsye të dyshon se do mundohesh të pengon largimin nga shteti, mund të obligon ty që të lajmërohesh në entin policor ose në qendrën pranuese në ditët e caktuara. Policia poashtu mund të vendos që të mbajnë mbyllur. Njësia ku mbahen mbyllur është njësi e mbyllur dhe nuk mund të largohesh nga ai vend. Fëmijët rrallë mbahen mbyllur. Fëmijët nën moshën 15 vjeçare që janë pa mbikqyrës ose pa prindër nuk mund të mbahen mbyllur fare.



ANKESA NË VENDIMIN

- Ke të drejtë që në vendimin e Drejtorisë së imigracionit ti ankohesh Gjykatës administrative. Së bashku me vendimin do të merr shtesën me udhëzimet për bërjen e ankesës apo apelit. Në shtesë tregohet dhe afati gjatë të cilit duhet bërë ankesa. Përfaqesuesi yt dhe asistenti juridik apo avokati shkruajnë ankesën së bashku me ty.
- Gjykata administrative mund ta mbanë në fuqi vendimin, ta ndryshon vendimin ose të urdhëron që Drejtoria e imigracionit ta shqyrton lëndën tënde përsëri.
- Pas vendimit të Gjykatës administrative mund të kërkosh leje për tu ankuar nga Gjykata supreme administrative. Kjo gjykatë nuk i shqyrton të gjitha ankesat. Pas kësaj nuk mund të ankohesh më në vendimin i cili bëhet përfundimtar.
- Vëni re se gjatë fazës së apelit Drejtoria e imigracionit nuk mund të jep informacione për shqyrtimin e lëndës sate. Përfaqesuesi yt informacionet i merr vetëm nga avokati yt.

TË DREJTAT E TUA

Mund të kërkosh këshilla nga avokati.



Ke të drejtë në ndihmë juridike, pra të takon avokatin gjatë tërë kohës së procesit të azilit. Sipas nevojës, përfaqesuesi ta gjenë avokatin dhe mbanë kontaktet me te.

Detyra e avokatit është që të këshillon në të gjitha gjërat lidhur me procesin e aplikimit. Avokati nuk të ndihmon në gjërat tjera.

Në takimet me zyrtarët përdoret përkthyesi.



Përkthyesi flet gjuhën që ti e kupton. Ai është i pranishëm ose përkthen përmes telefonit ose përmes video lidhjeve. Përkthyesit kanë obligimin e ruajtjes së fshehtësisë dhe janë neutral.

Për lëndën tënde mund të informohesh.



Ke të drejtë të njohesh me dokumentet që të përkasin ty. Mund të kërkosh me shkrim nga Drejtoria e imigracionit p.sh. dokumente që lidhen me vendimin ose intervistën tënde. Informacione lidhur me aplikacionin tënd nuk ipen përmes telefonit.

Mund të punosh nëse je mbi 15 vjeçar.



Në Finlandë fëmijët nuk punojnë por vijnë shkollën. Nëse dëshiron të punosh, duhet ti jesh mbi 15 vjeç.

Punës mund të ia fillosh pas disa muajsh nga data e aplikimit tënd për azil. Për mundësinë për punë informohesh nga punonjësit e qendrës pranuese dhe në internet faqet e Drejtorisë së imigracionit migri.fi.

Mund të kthehesh në vendlindje.



Në çfardo kohe mund ta anulon aplikacionin tënd dhe të kthehesh në vendlindjen tënde. Për këthim mund të aplikosh për asistencë monetare. Për këtë gjë bisedo me përfaqesuesin tënd dhe me punonjësin social.

Sipas nevojës mund të bësh aplikacion të ri .



Nëse kanë ndodhur ndryshime të dukshme në gjendjen tënde pas marrjes së vendimit përfundimtar, ti mund të bësh aplikacion të ri për azil. Trego për gjendjen e ndryshuar si dhe për bazat tua të reja menjëherë gjatë bërjes së aplikacionit të ri. Nëse nuk ke arsye të reja për të aplikuar për azil, ty të bëhet vendimi për mos shqyrtimin e aplikacionit.



OBLIGIMET TUA

Të ndihmosh sqarimin e lëndës tënde.

Ti duhet të flet të vërtetën zyrtarëve dhe të ndihmosh sqarimin e gjërave lidhur me aplikacionin tënd. Kjo don të thotë p.sh. që në intervistë ti tregosh të gjitha arsyet për shkak të cilave kërkon azil. Nëse ke treguar të dhëna të rrejshme, leja jote mund të anulohet më vonë.

Qëndro në Finlandë gjatë kohës së shqyrtimit të aplikacionit tënd.

Nuk guxon të largohesh nga Finlanda deri sa të mos përfundon shqyrtimi i aplikacionit tënd. Aplikacioni yt anulohet, pra shqyrtimi përfundon,

- nëse nuk mund të të kontaktojmë gjatë dy muajve ose
- nëse zyrtarët kuptojnë se je larguar nga Finlanda.

Eja në takime.

Ti duhet të vijsh në takimet e caktuara. Nëse nuk vjen në intervistën e azilit pa ndonjë arsye të pranueshme, aplikacioni yt mund të vendoset pa intervistë fare.

Nëse je sëmurë, lajmëro qendrën pranuese sa më shpejtë që të jetë e mundur. Më pastaj, vërtetimin e mjekut ia dërgon Drejtorisë së imigracionit.

Dërdoi të gjitha dokumentet lidhur me aplikacionin tënd Drejtorisë së imigracionit

Nëse ke pasaportë, kartë identifikimi ose dokumente tjera që lidhen me aplikacionin tënd, ia jep përfaqësuesit tënd që ti dërgon Drejtorisë së imigracionit.

Përditësoi kontakt-shenimet tua.

Lajmëro numrin e telefonit qendrës pranuese. Përgjigju në telefon nëse të telefonon punonjësi i qendrës pranuese. Lajmëro qendrën pranuese gjithmonë nëse ndryshon numrin e telefonit.

GJËRAT TJERA ME RËNDËSI

Kërkimi i mbikqyrësve

Nëse nuk din se ku e ke mbikqyrësit ose prindërit apo nuk mund të kontakton me te, Drejtoria e imigracionit mundohet të sqaron se ku gjinden dhe të vën kontakt me ta. Tregoi përfaqësuesit tënd nëse, për ndonjë arsye, nuk dëshiron që të kontaktojmë me prindërit tu. Prindërit mund ti kërkon edhe me ndihmën e Kryqit të kuq. Për më tepër pyete përfaqësuesin tënd.



Testimi i moshës

Është me rëndësi që zyrtarët ta dijnë moshën tënde të saktë. Mund të ndodhë që mos të kesh pasaportë ose dokument zyrtar identifikimi nga i cili mund të verifikohet mosha jote. Në atë situatë mosha kryesisht sqarohet më saktësisht p.sh. me testin e moshës.



Testi i moshës bëhet vetëm nëse Drejtoria e imigracionit e sheh si të nevojshëm. Nga ti dhe nga përfaqësuesi yt kërkohet pëlqimi për testim. Nëse refuzon testimin pa ndonjë arsye të pranueshme, të llogarisim si të moshës madhore.

Testimi nuk zgjatë shumë dhe nuk të dhemb fare. Në testim mjeku të interviston, bisedon me ty dhe ti fotografon dhëmbët duart në röntgen.

Deklaratën për moshën tënde e japin ekspertët. Nëse sipas testit je i moshës së mitur, asgjë nuk ndryshon. Nëse sipas testit je i moshës tjetër nga ajo që ke thënë ti vet, atëherë ti dhe përfaqësuesi mund ta thuani mendimin e juaj për këtë gjë. Nëse pas kësaj për ty dëshmohet se je i moshës madhore, më tutje ty të trajtojnë si azilkërkues të rritur. Shpërngulesh në qendrën pranuese për të rriturit. Poashtu përfundon edhe detyra e përfaqësuesit tënd.

SHIQO VIDEOT PËR AZILKËRKIM NË YOUTUBE-KANALIN E DREJTOSRISË SË IMIGRACIONIT

- Aplikimi për azil në Finlandë
- Në cilat baza mund të merr lejen e qëndrimit?
- Kush bën dhe çka bën në procesin e azilit?
- Ndihma juridike në procesin e azilit
- Intervista e azilit
- Pritja e vendimit
- Vendimi pozitiv
- Vendimi negativ

migri.fi/videot-turvapaikanhakijoille

Videot janë në këto gjuhë: finlandishte, anglishte, arabe, dari, persishte, rusishte, somaleze, sorane, turke.





Maahanmuuttovirasto
Migrationsverket
Finnish Immigration Service



**TURVAPAIKKA-,
MAAHANMUUTTO- JA
KOTOUTTAMISRAHASTO**

Euroopan unionin tuella

KONTAKT-SHENIME

Drejtoria e imigracionit

adresa postale: PL 10,
00086 Maahanmuuttovirasto
telefoni: 0295 419 600
posta elektronike: migri@migri.fi
migri.fi

I autorizari për barazi

adresa postale: PL 24,
00023 Valtioneuvosto
telefoni: 0295 666 817
posta elektronike: yvv@oikeus.fi
www.syrjinta.fi

Zyra e afërt e të autorizuarit kryesor i KB për çështjet e refugjatëve, UNHCR

adresa: Wenner-Gren Center,
Sveavägen 166,
11346 Stockholm, Suedi
telefoni: +46 10 10 12 800
posta elektronike: swest@unhcr.org
www.unhcr.org

migri.fi